



Familja
Syntech

Tipologjia
Rrëshirë poliuretani hidroekspansive dhe artikuj të ngjashëm

Linjat e produkteve
• Aqua
• Infratech

Kategoritë e përdorimit
• Ndalim i menjëhershëm i depërtimit të ujit me presion në ndërtesa

Përbërësit
Monokomponent

Paraqitja
Pajisje mekanike

SYN.0190

SYNTECH HAG POMPA AZ-PT/B

Pompë manuale me presion 40

Kodi doganor

8413 2000

Amballazhimi

- Të hapura 1 copë

Aplikimi

- Aplikim manual
- Injeksion

Përshkrimi i produktit

Pompë manuale me një pistë, me vetëmbushje, me një përdorim, për të injektuar rrëshirën e poliuretanit dhe lëngje epoksi. Presioni maksimal i pompës është 40 bar. Shkalla e rrjedhjes është 1 litër në 55 cikle.

Të dhëna shtesë

SYNTECH HAG POMPA AZ-PT/B ka një madhësi prej 65 x 110 cm dhe është e pajisur me një stendë të zgjatur teleskopike, për të rregulluar lartësinë sipas nevojave specifike të punonjësit që e përdor atë. Lartësia nga toka varion nga 85 cm deri në 125 cm.

Konsumi

Produkti të blihet sipas nevojës.

Fushat e përdorimit

Për injeksione në mure të rrëshirave të poliuretanit hidro-shtrëngues për ndalimin e depërtimit të ujit dhe / ose për rrëshirën e rrjedhshme epokside për përforsim të mureve.

Vetitë kryesore



I pandezhëm



Jetëgjatësi e pakufizuar



Ngjyrat në dispozicion
E zezë

Mjetet e pastrimit

• Diluent Nitro

Shtresat e lejuara

- Beton
- Tulla
- Shtuf
- Muratura të përziera
- Muratura me gurë

Përgatitja e shtresave (mbështetëse)

Instaloni injektuesit e SYNTECH HAG INIETTORE 120 ose SYNTECH HAG INIETTORE 170 siç specifikohet në fletët përkatëse të të dhënave..



www.azichem.com

Përditësimi më: **25/08/2020**
Kushtet e shitjes dhe parashikimet
ligjore mund të lexohen në
www.azichem.it/disclaimer

Mënyra e përdorimit

Lidhni zorrën me presion të lartë me pompën tek injektori i posaçëm, i cili është vendosur në mënyrë të përshtatshme në muraturë. Zhyteni tubin thithës që furnizon pompën (tub plastik të përforcuar) në kontejner (kovë, shishe, etj.), që përmbajnë rrëshirë për t'u injektuar. Futeni tubin e lehtësimit të presionit (tub plastik transparent) në të njëjtën enë. Filloni operacionet e injektimit duke pompuar rrëshirën në injektorët nëpërmjet përdorimit të levës së pompës. Gjatë ngopjes së zgavrës ku duhet të bëhet injektimi, presioni i lëngut të injektuar duhet të jetë i tillë që të pengojë funksionimin e levës; në atë moment do të jetë e nevojshme që avash-avash të lehtësohet tërësisht presioni duke lëvizur çelësin e ndezjes. Shkëputni tubin nga injektori i përdorur dhe lidhni atë me një injektor të ri. Përsëriteni procedurën për çdo injektues.

Në fund të çdo injeksioni dhe para ruajtjes së pompës në magazinë, rekomandohet patjetër të pastrohet tërësisht duke qarkulluar hollues Nitro për disa minuta, dhe më pas duke qarkulluar pastruesin vajor të posaçëm SYNTECH HAG CLEANER.

Magazinimi e Ruajtja

Mbrojeni nga lagështia.



Paralajmërimi, Masa paraprake, Ekologji

Të dhënat e përgjithshme, ashtu si dhe indikacionet dhe sugjerimet për përdorimin e këtij produkti, të paraqitura në këtë fletë teknike të të dhënave dhe mundësisht të shpjeguara dhe me gojë ose me shkrim, përputhen me gjendjen aktuale të njohurive tona shkencore dhe praktike.

Të dhënat teknike dhe të performancës të paraqitura janë rezultat i provave laboratorike të kryera në një mjedis të kontrolluar dhe si të tilla mund të ndryshojnë në lidhje me kushtet e vënies në funksionim.

Azichem Srl nuk merr asnjë përgjegjësi që rrjedhin nga performanca jo e duhur që ka lidhje me përdorimin jashtë rregullave të produktit, ose që ka lidhje me defektet që rrjedhin nga faktorë ose elementë që nuk kanë lidhje me cilësinë e produktit, duke përfshirë këtu dhe konservimin e pasaktë.

Kushdo që synon të përdorë produktin duhet të vendosë, para përdorimit, nëse është i përshtatshëm për përdorimin e synuar, duke marrë parasysh të gjithë përgjegjësinë e tij.

Karakteristikat teknike dhe të performancës të përfshira në këtë fletë të dhënash teknike përditësohen në mënyrë periodike. Për një konsultë në kohë reale lidhuni me sitin: www.azichem.com. Data e rishikimit paraqitet në cep të produktit. Ky njoftim anulon dhe zëvendëson çdo njoftim tjetër të mëparshëm.

Mos harroni se përdoruesi është i detyruar të lexojë Fletën më të fundit të të Dhënave të Sigurisë së këtij produkti, që përmban të dhëna kimike-fizike dhe toksikologjike, parashikimet e rrezikut dhe informacione të tjera me qëllim që të transportojë, përdorë dhe asgjësojë produktin dhe paketimin e tij me siguri të plotë. Për konsultim lidhuni me sitin: www.azichem.com.

Ndalohet hedhja e produktit dhe / ose amballazhit të tij në mjedis.

Mos e shkëputni tubin ende nën presion nga injektori i përdorur, përpara se mbarojë plotësisht presionin! Pompa mund të arrijë presin 40 bar, dhe kështu ka një rrezik serioz për t'u lënduar, nëse presioni nuk është lehtësuar paraprakisht, siç u përkrahua. Mospastrimi i pompës sipas masave të përkrahura më lart, mund të shkaktojë bllokimin total të qarkut hidraulik të pompës, duke e bërë atë përkohësisht të papërdorshme, derisa të pastrohet mirë dhe plotësisht. Gjithashtu, mund të jetë i nevojshëm zëvendësimi i plotë ose i pjesshëm i valvulave (o-ring).



www.azichem.com

Përditësimi më: 25/08/2020
Kushtet e shitjes dhe parashikimet
ligjore mund të lexohen në
www.azichem.it/disclaimer



Via Giovanni Gentile, 16/A - 46044 Goito (MN), Itali
info@azichem.com Tel. +39 0376.604185 /604365 Fax +39 0376 604398



www.azichem.com

Përditësimi më: **25/08/2020**
Kushtet e shitjes dhe parashikimet
ligjore mund të lexohen në
www.azichem.it/disclaimer